**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**
**GJYKATA ADMINISTRATIVE**

# ORARI I PUNËS
# I GJYKATËS ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2021

**– për kryetarin e gjykatës dhe gjykatësit –**

---

**Shkup, dhjetor 2020**

Kryetari i Gjykatës Administrative, Mr. Burim Sejdini, në përputhje me nenin 88 të Ligjit të Gjykatave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.58/2006, 35/2008, nr. 150/2010 dhe nr. 96/19) dhe nenit 112 dhe 174 paragrafi 4 i Rregullores së gjykatës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2013 dhe nr. 114/2014), pas seancës paraprake të gjykatësve, të mbajtur më 29.12.2020, miratoi:

**ORARIN E PUNËS TË**
**GJYKATËS ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2021**

**– për kryetarin e gjykatës dhe gjykatësit –**

**I**

Kryetar i Gjykatës Administrative është Burim Sejdini.

Për zëvendës të kryetarit të Gjykatës Administrative, caktohet gjykatësja Dimitrulla Apostollovska.

Zëvendësi i kryetarit të Gjykatës, përveç në punën e rregullt gjyqësore, do ta zëvendësojë kryetarin në rast se ai mungon ose pengohet në ushtrimin e funksionit të tij.

**II**

**SEKCIONET E SPECIALIZUARA GJYQËSORE**

Puna me lëndët në Gjykatën Administrative, zhvillohet në këto seksione të specializuara gjyqësore:

**I – SEKCIONI I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR FUSHËN PRONËSORE-JURIDIKE, DENACIONALIZIM, URBANIZËM, NDËRTIMTARI DHE TË DREJTA TË TJERA TË NGJASHME (Lëndët nga fusha pronësore-juridike evidentohen në Regjistrin “U-1” si dhe në regjistrat “UPR”, “URP”, USPI” dhe “UPOV”; Lëndët nga fusha e denacionalizimit, urbanizmit, ndërtimtarisë dhe e të drejtave të tjera të ngjashme evidentohen në Regjistrin “U-2” dhe “U-3” si dhe në regjistrat “UPR”, “URP”, USPI” dhe “UPOV”)**

1. Në kuadër të këtij seksioni formohet këshill për fushën pronësore-juridike dhe për të drejtat e tjera të ngjashme, ku sistemohen gjykatësit: Aneta Xhigerova - kryetare e këshillit, Bllagorodna Arangjellova - anëtare e këshillit dhe Imsale Hasani - anëtare e këshillit.

2. Në kuadër të këtij seksioni, formohen dy këshilla për denacionalizim, urbanizëm, ndërtimtari dhe për të drejta të tjera të ngjashme. Në këshillin e parë sistemohen gjykatësit: Dragosllav Radiçevski - kryetar i këshillit, Lulzim Saliu - anëtar i këshillit, Drita Memeti - anëtare e këshillit dhe Snezhana Tërpovska - anëtare e këshillit, ku gjykatësja Snezhana Tërpovska, si anëtare e këshillit, lëndët e saj do t'i procedojë dhe vendos në vend të anëtares

së këshillit - gjykatëses Drita Memeti. Në këshillin e dytë sistemohen gjykatësit: Vesna Jovanovska - kryetare e këshillit, Gabrijella Mihajllovska - anëtare e këshillit, Eleonora Hamuliq Ajro - anëtare e këshillit dhe Aleksandar Çiçakovski - anëtar i këshillit, ku gjykatësi Aleksandar Çiçakovski, si anëtar i këshillit, lëndët e tij do t'i procedojë dhe vendos në vend të anëtares së këshillit - gjykatëses Eleonora Hamuliq Ajro.

3. Në këtë seksion, formohet një këshill prej pesë gjykatësve që do të vendosin në bazë të padive për përsëritjen e procedurës nga fusha pronësore-juridike dhe e të drejtave të tjera të ngjashme, ku sistemohen gjykatësit: Aneta Xhigerova - kryetare e këshillit, Bllagorodna Arangjelova- anëtare e këshillit, Imsale Hasani - anëtare e këshillit, Lulzim Saliu - anëtar i këshillit dhe Gabrijella Mihajllovska - anëtare e këshillit.

4. Në këtë seksion, formohen dy këshilla prej pesë gjykatësve, të cilët do të vendosin në bazë të padive për përsëritjen e procedurës nga fusha e denacionalizimit, urbanizmit, ndërtimtarisë dhe e të drejtave të tjera të ngjashme, edhe atë në këshillin e parë sistemohen gjykatësit: Dragosllav Radiçevski - kryetar i këshillit, Lulzim Saliu - anëtar i këshillit, Drita Memeti - anëtare e këshillit, Snezhana Tërpovska - anëtare e këshillit dhe Eleonora Hamuliq Ajro - anëtare e këshillit, kurse në këshillin e dytë sistemohen gjykatësit: Vesna Jovanovska - presidente e këshillit, Gabriela Mihajlovska - anëtare e këshillit, Eleonora Hamulic Ajro - anëtare e këshillit Aleksandar Çiçakovski - anëtare e këshillit dhe Drita Memeti - anëtare e këshillit.

Lidhur me vendosjen ndaj propozimeve për përsëritjen e procedurës, Gjykata Administrative, nëse vendos për propozimin e paraqitur për përsëritjen e procedurës sipas Ligjit të Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 62/06 dhe 150/10), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej pesë gjykatësve, kurse kur propozimi për përsëritjen e procedurës dorëzohet pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" Nr. 96/19), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej tre gjykatësve.

**II- SEKSION I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR PENSIONE, TË DREJTA NGA SIGURIMI PENSIONAL DHE INVALIDOR, DOGANA, KONCESIONE, PARTNERITETE PUBLIKE-PRIVATE DHE PËR TË DREJTA TË TJERA TË NGJASHME (Lëndët nga fushat e pensioneve, e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe e të drejtave të tjera të ngjashme evidentohen në Regjistrin "U-4" si dhe në regjistrat "UPR", "URP", USPI" dhe "UPOV" dhe Lëndët nga fusha e doganave, koncesioneve, partneriteteve publike-private dhe e të drejtave të tjera të ngjashme evidentohen në Regjistrin "U-6" si dhe në regjistrat "UPRC", "URP", "USPI" dhe "UPOV".**

1. Në kuadër të këtij seksioni formohet këshill për pensione, të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe për të drejta të tjera të ngjashme, ku sistemohen gjykatësit: Lidija Ivanovska - kryetare e këshillit, Edita Naskovska - anëtare e këshillit dhe Nada Ivanova - anëtare e këshillit, e cila do të veprojë si anëtare e këshillit në Këshillin e dytë për dogana, koncesione, partneritete publike-private dhe për të drejta të tjera të ngjashme, pa u

shpërndarë lëndët në punën e gjykatësit nëpërmjet sistemit të automatizuar kompjuterik AKMIS.

2. Në kuadër të këtij seksioni formohen dy këshilla për dogana, koncesione, partneritete publike-private dhe për të drejta të tjera të ngjashme. Në këshillin e parë sistemohen gjykatësit: Marta Telegravçiska - kryetare e këshillit, Ramije Cara - anëtare e këshillit dhe Gjoko Zhivkoski - anëtar i këshillit. Në këshillin e dytë, sistemohen gjykatësit: Tanja Terzieva - kryetare e këshillit, Gazmend Fejzuli - anëtar i këshillit, Elizabeta Vaskova - anëtare e këshillit dhe Gordana Ilievska - anëtare e këshillit, ku gjykatësja Gordana Ilievska si anëtare e këshillit, lëndët e saj do t'i procedojë dhe vendos në vend të anëtares së këshillit - gjykatëses Elizabeta Vaskova.

3. Në këtë seksion, formohet edhe këshill prej pesë gjykatësve, të cilët do të vendosin për paditë për përsëritjen e procedurës nga fusha e pensioneve, e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe e të drejtave të tjera të ngjashme, ku sistemohen gjykatësit: Lidija Ivanovska - kryetare e këshillit, Edita Naskovska - anëtare e këshillit, Nada Ivanova - anëtare e këshillit, Gjoko Zhivkoski - anëtar i këshillit dhe Elizabeta Vaskova - anëtare e këshillit.

4. Në këtë seksion, formohen dy këshilla prej pesë gjykatësve, të cilët do të vendosin për paditë për përsëritjen e procedurës nga fusha e pensioneve, e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe e të drejtave të tjera të ngjashme, ku sistemohen gjykatësit: Marta Telegravçiska - kryetare e këshillit, Ramije Cara - anëtare e këshillit, Gjoko Zhivkoski - anëtar i këshillit, Gazmend Fejzuli - anëtar i këshillit dhe Elizabeta Vaskova - anëtare e këshillit, ndërsa në këshillin e dytë sistemohen gjykatësit: Tanja Terzieva - kryetare e këshillit, Gazmend Fejzuli - anëtar i këshillit, Elizabeta Vaskova - anëtare e këshillit, Ramije Cara - anëtare e këshillit dhe Gjoko Zhivkoski - anëtar i këshillit. Gjykatësja Gordana Ilievska - anëtare e këshillit, do të vendosë për paditë për përsëritjen e procedurës nga fusha e pensioneve, e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe e të drejtave të tjera të ngjashme, si anëtare e pestë në këshillin prej pesë gjykatësve në vend të gjykatësit Gjoko Zhivkoski - anëtar i këshillit.

Lidhur me vendosjen ndaj propozimeve për përsëritjen e procedurës, Gjykata Administrative, nëse vendos për një propozim të dorëzuar për përsëritjen e procedurës sipas Ligjit të Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/06 dhe 150/10), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej pesë gjykatësve, ndërsa kur propozimi për përsëritjen e procedurës është dorëzuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/19), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej tre gjykatësve.

**III – SEKSION I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR ÇËSHTJE FINANCIARE DHE TË DREJTA TË TJERA TË NGJASHME (Lëndët që janë në kompetencë të këtij seksioni evidentohen në Regjistrin "U-5" si dhe në regjistrat "UPRD", "URP", "USPI" dhe "UPOV")**

1. Në kuadër të këtij seksioni formohen tre këshilla. Në këshillin e parë sistemohen gjykatëset: Dimitrulla Apostolovska - kryetare e këshillit, Valentina Koneska - anëtare e

këshillit dhe Biljana Nikodinovska - anëtare e këshillit. Në këshillin e dytë sistemohen gjykatëset: Diturie Elezi Neziri - kryetare e këshillit, Ana Gerasimovska - anëtare e këshillit dhe Daniella Antovska - anëtare e këshillit. Në këshillin e tretë sistemohen gjykatëset: Esma Alibashiq Jonuz - kryetare e këshillit, Violeta Bogojevska - anëtare e këshillit dhe Elmedine Asani - anëtare e këshillit.

2. Në kuadër të këtij seksioni formohen dy këshilla prej pesë gjykatësve që do të vendosin për paditë për përsëritjen e procedurës në fushat që janë në kompetencë të seksionit, edhe atë këshilli i parë ku sistemohen gjykatëset: Dimitrulla Apostolovska - kryetare e këshillit, Esma Alibashiq Jonuz - anëtare e këshillit, Valentina Koneska - anëtare e këshillit, Biljana Nikodinovska - anëtare e këshillit dhe Elmedine Asani - anëtare e këshillit dhe këshilli i dytë ku sistemohen gjykatëset: Diturie Elezi Neziri - kryetare e këshillit, Ana Gerasimovska - anëtare e këshillit, Daniella Antovska - anëtare e këshillit, Violeta Bogojevska - anëtare e këshillit dhe Valentina Koneska - anëtare e këshillit.

Lidhur me vendosjen ndaj propozimeve për përsëritjen e procedurës, Gjykata Administrative, nëse vendos për propozimin e paraqitur për përsëritjen e procedurës sipas Ligjit të Kontesteve Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/06 dhe 150/10), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej pesë gjykatësve, ndërsa kur propozimi për përsëritjen e procedurës dorëzohet pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Kontesteve Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 ), do të veprohet dhe vendoset në këshillat prej tre gjykatësve.

**III**

Kryetari i Gjykatës Administrative, si gjykatës i kësaj gjykate, nuk vepron dhe nuk vendos për lëndët e shpërndara nëpërmjet sistemit të automatizuar të informacionit për menaxhimin e lëndëve - AKMIS. Nga pranimi i lëndëve të reja, kryetari i gjykatës është përjashtuar që nga data 01.09.2018, në bazë të një vendimi të posaçëm të marrë.

Kryetari i Gjykatës Administrative, si gjykatës i kësaj gjykate, nuk vepron dhe nuk vendos për lëndët që do të regjistrohen në Gjykatën Administrative, për paditë që dalin nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, duke marrë parasysh obligimet e përcaktuara të kryetarit të Gjykatës Administrative, në përputhje me Ligjin e Gjykatave, sa i takon organizimit të punës së gjykatës dhe marrjen e masave për kryerjen në kohë dhe në mënyrë të rregullt të punëve në gjykatë dhe në përputhje me Rregulloren e gjykatës, sa i takon miratimit të fotografimit, incizimit në gjykatë dhe paraqitjen publike, e posaçërisht sa i takon informimit në kohë të publikut për punën e gjykatës gjatë procedurës për mbrojtjen e së drejtës zgjedhore.

**IV**

1. Seancat e këshillave do të mbahen të paktën një herë në javë, ndërsa seancat e këshillave që vendosin për paditë për përsëritjen e procedurës, do të mbahen sipas nevojës.

2. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Aneta Xhigerova, si kryetare e këshillit prej katër gjykatësve dhe si kryetare e këshillit prej pesë

gjykatësve në seksionin e parë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Vesna Jovanovska. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Vesna Jovanovska, si zëvendësim të gjykatëses Aneta Xhigerova, atë do ta zëvendësojë gjykatësi Dragosllav Radiçevski.

3. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Vesna Jovanovska, si kryetare e këshillit prej tre gjykatësve dhe si kryetare e këshillit të tretë prej pesë gjykatësve në seksionin e parë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Aneta Xhigerova. Në rast pengimi dhe mungese për shkaqe të arsyeshme të gjykatëses Aneta Xhigerova, si zëvendësim për gjykatësen Vesna Jovanovska, atë do ta zëvendësojë gjykatësi Dragosllav Radiçevski.

4. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatësit Dragosllav Radiçevski, si kryetar i këshillit prej katër gjykatësve në seksionin e parë të specializuar dhe si kryetar i këshillit të dytë prej pesë gjykatësve për paditë për përsëritje të procedurës në seksionin e parë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Vesna Jovanovska. Në rast të pengimit dhe mungesës për shkaqe të arsyeshme të gjykatëses Vesna Jovanovska, si zëvendësim për gjykatësin Dragosllav Radiçevski, atë do ta zëvendësojë gjykatësja Aneta Xhigerova.

5. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Lidija Ivanovska, si kryetare e këshillit prej tre gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar dhe si kryetare e këshillit prej pesë gjykatësve për paditë për përsëritje të procedurës në seksionin e dytë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Marta Telegravçiska. Në rast të pengimit dhe mungesës për shkaqe të arsyeshme të gjykatëses Marta Telegravçiska, si zëvendësim i gjykatëses Lidija Ivanovska, atë do ta zëvendësojë gjykatësja Tanja Tezrieva.

6. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Marta Telegravçiska, si kryetare e këshillit të dytë prej tre gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të dytë prej pesë gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Tanja Terzieva, si kryetare e këshillit të tretë prej tre gjykatësve nga i njëjti seksion i specializuar. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Tanja Terzieva, si zëvendësim i gjykatëses Marta Telegravçiska, si kryetare e këshillit të dytë prej tre gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të dytë prej pesë gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar, do ta zëvendësojë gjykatësja Lidija Ivanovska.

7. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Tanja Terzieva, si kryetare e këshillit të tretë prej tre gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të tretë prej pesë gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Marta Telegravçiska. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Marta Telegravçiska, si zëvendësim i gjykatëses Tanja Terzieva, si kryetare e këshillit të tretë prej tre gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të dytë prej pesë gjykatësve në seksionin e dytë të specializuar, do ta zëvendësojë gjykatësja Lidija Ivanovska.

8. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Dimitrulla Apostollovska, si kryetare e këshillit të parë prej tre gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të parë prej pesë gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Diturie Elezi Neziri. Në rast të pengimit dhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Diturije Elezi Neziri, si zëvendësuese e gjykatëses Dimitrulla Apostollovska, si kryetare e këshillit të parë prej tre gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar, do ta zëvendësojë gjykatësja Esma Alibashiq Jonuz. Në rast pengimi dhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Diturije Elezi Neziri, si zëvendësuese e gjykatëses Dimitrulla Apostollovska, si kryetare e këshillit të parë prej tre gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar, do ta zëvendësojë gjykatësja Tanja Terzieva.

9. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Diturie Elezi Neziri, si kryetare e këshillit të dytë prej tre gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar dhe si kryetare e këshillit të dytë prej pesë gjykatësve në seksionin e tretë të specializuar, atë e zëvendëson gjykatësja Esma Alibashiq Jonuz. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Esma Alibashiq Jonuz, si zëvendësuese e gjykatëses Diturie Elezi Neziri, atë do ta zëvendësojë gjykatësja Dimitrulla Apostollovska.

10. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Esma Alibashiq Jonuz, si kryetare e këshillit të tretë prej tre gjykatësve nga seksioni i njëjtë i specializuar, atë do ta zëvendësojë gjykatësja Dimitrulla Apostollovska. Në rast mungese, pengimi ose për shkaqe të tjera të arsyeshme të gjykatëses Dimitrulla Apostollovska, si zëvendësuese e gjykatëses Esma Alibashiq Jonuz, atë do ta zëvendësojë gjykatësja Diturie Elezi Neziri.

11. Në rast mungese ose pengimi të një anëtari të këshillit të një seksioni të caktuar, zëvendësimi i anëtarit të këshillit do të kryhet në të njëjtën mënyrë, siç është përcaktuar për kryetarin e këshillit të lartpërmendur. Në rast mungese ose pengimi të zëvendësit të anëtarit të këshillit, i njëjti do të zëvendësohet, sipas radhitjes, njëjtë siç është përcaktuar për zëvendësimin e kryetarit të këshillit.

12. Në këshillat ku janë sistemuar nga katër gjykatës, në rast të mungesës ose pengimit të ndonjë anëtari të këshillit, të njëjtin do ta zëvendësojë anëtar tjetër që është i pranishëm. Nëse edhe anëtari tjetër mungon ose pengohet, në këtë rast, zëvendësimi i anëtarëve të këshillit do të bëhet në përputhje me pikën 11 të këtij orari.

## IV-a

Në Këshillin për praktikë gjyqësore të Gjykatës Administrative, sistemohen gjykatësit: Nada Ivanova - kryetare e këshillit për praktikë gjyqësore, Aneta Xhigerova - anëtare e këshillit, Dragosllav Radiçevski - anëtar i këshillit, Vesna Jovanovska - anëtare e këshillit, Lidija Ivanovska - anëtare e këshillit, Dimitrulla Apostollovska - anëtare e këshillit, Diturie Elezi Neziri - anëtare e këshillit, Esma Alibashiq Jonuz - anëtare e këshillit, Marta Telegravçiska - anëtare e këshillit dhe Tanja Terzieva - anëtare e këshillit.

Gjykatësja Nada Ivanov, e sistemuar si kryetare e Këshillit për praktikë gjyqësore dhe anëtare e Këshillit për pensione, të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe për të

drejta të tjera të ngjashme pranë seksionit të dytë të specializuar për pensione, të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor, dogana, koncesione, partneritete publike-private dhe për të drejta të tjera të ngjashme, njëkohësisht caktohet edhe për të vepruar ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me lëndët e arkivuara për të gjitha bazat, e që i përfshinë veprimet procedurale si:

- vendosjen e vërtetimeve të plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë
- miratimin e kërkesave për shqyrtim dhe dhënie të shkresave
- të vepruarit ndaj kërkesave për përmirësimin e vendimeve gjyqësore dhe
- shfrytëzimin e mjeteve juridike

**V**

**ZYRA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nëpunësja gjyqësore **Snezhana Kiprovska - udhëheqëse e Shërbimit juridik profesional**, sistemohet t'i kryejë detyrat profesionale që janë në kompetencë të administratës gjyqësore për nevojat e kryetarit të gjykatës si dhe obligimet nën kompetencë të administratorit gjyqësor.

**VI**

Nëpunësja gjyqësore profesionale, bashkëpunëtore e lartë gjyqësore **Ivana Smugreska**, sistemohet për drejtimin e bibliotekës së gjykatës, ndërsa njëherazi emërohet si person përgjegjës për marrëdhënie me publikun, në zyrën e marrëdhënieve me publikun.

**VII**

Nëpunësi gjyqësor **Murat Adillovski**, referent gjyqësor i ri - nëpunës në zyrën e shkresave, sistemohet për kryerjen e punëve në zyrën gjyqësore të shkresave që kanë të bëjmë me shpërndarjen dhe rishpërndarjen automatike të lëndëve të gjykatësve nëpërmjet sistemit AKMIS.

**VIII**

**POLICIA GJYQËSORE**

**Aleksandar Kostovski -** pjesëtar i policisë gjyqësore

**Elena Kostadinovska -** pjesëtare e policisë gjyqësore

**Sime Kotevski -** pjesëtar i policisë gjyqësore

**Borçe Çekiçevski -** pjesëtar i policisë gjyqësore

Orari për kryerjen e obligimeve të punës i pjesëtarëve të policisë gjyqësore caktohet në nivel mujor.

**IX**

Koha për pranimin e palëve në gjykatë është çdo ditë pune nga ora 9.00 deri në orën 14.30.

Si ditë për pranimin e palëve, kryetari i gjykatës e cakton çdo të martë nga ora 9.00 deri në orën 14.00.

*Përkthimin në gjuhën shqipe e organizoi: Bashkëpuntor-përkthyes,Rexhep Ademi

**KRYETAR I GJYKATËS ADMINISTRATIVE**
**Mr. Burim Sejdini**